



PANORAMË E BASHKIMIT EVROPIAN

Përmbajtja

ÇFARË ËSHTË BASHKIMI EVROPIAN?	5
EURO-MONEDHA E VETME E EVROPIANËVE!	6
TË LIRË PËR TË LËVIZURI!	6
PAQEDASHËSI!	7
VEND I LIRISË, I SIGURISË DHE I DREJTËSISË!	8
MË PAK KUFIJ: MË TEPËR PUNË!	9
SHOQËRI E INFORMACIONIT PËR TË GJITHË!	10
KUJDESI PËR AMBIENTIN!	11
PARLAMENTI EVROPIAN	12
KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN	14
KOMISIONI EVROPIAN	18
GJYKATA E DREJTËSISË	20
GRUPI EVROPIAN I AUDITORËVE	20
BANKA QENDRORE EVROPIANE1	21
BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE	21
KOMITETI I ÇËSHITJEVE SOCIALE DHE EKONOMIKE	22
KOMITETI RAJONAL	22
SHTRIRJE PËR NJË EVROPË MË TË FORTË DHE TË QËNDRUESHME ...	23
HISTORIKU I SHTRIRJES SË BASHKIMIT EVROPIAN.	23
RUAJTJA E DEMOKRACISË EVROPIANE	24
SI MUND TË KONTAKTOJMË ME BASHKIMIN EVROPIAN?	26



ÇFARË ËSHTË BASHKIMI EVROPIAN?

Bashkimi Evropian është një familje e madhe e vendeve demokratike evropiane, të angazhuara të punojnë së bashku për paqe dhe prosperitet. Nuk është një Shtet që kërkon të zërë vendin e shteteve ekzistuese, por është më tepër se çdo organizatë tjetër ndërkombëtare. Në fakt, Bashkimi Evropian është i vetëm. Shtetet anëtare të tij kanë ngritur institucione të përbashkëta, ku kanë deleguar një pjesë të sovranitetit të vet, me qëllim që vendimet mbi çështje me interes të përbashkët të merren në nivel evropian dhe në mënyrë demokratike.

Historia e Bashkimit Evropian i ka rrënjët në Luftën e Dytë Botërore. Ideja e integritimit lindi nga dëshira për të parandaluar përsëritjen e vrasjeve dhe të shkatërrimeve të luftës. Për herë të parë një ide e tillë u propozua nga Ministri i Punëve të Jashtme të Francës, Robert Schuman gjatë një fjalimi më 9 maj 1950.

Kjo datë, “ditëlindja” e atij që tani është Bashkimi Evropian, festohet çdo vit si Dita e Evropës.

Në vitet e para, bashkëpunimi midis vendeve të Bashkimit Evropian konsistonte në fushën e tregtisë dhe të ekonomisë, por tani Bashkimi Evropian mbulon mjaft aspekte të tjera që lidhen direkt me jetën tonë të përditshme.

Evropa është një kontinent me shumë tradita dhe ku fliten gjuhë të ndryshme, por edhe me shumë vlera të përbashkëta. Bashkimi Evropian i mbron këto vlera. Ai ushqen bashkëpunimin midis popujve të Evropës, nxit idenë e bashkimit të tyre ndërsa ruan origjinalitetin e secilit, dhe kujdeset që vendimet të merren sa më pranë qytetarëve evropianë.

Në një botë gjithnjë e më shumë të ndërruar të shekullit të XXI, spikat akoma më shumë nevoja që çdo qytetar evropian të bashkëpunojë me njerëz nga vende të tjera me një frymë njohjeje, tolerance dhe solidariteti.

EURO-MONEDHA E VETME E EVROPIANËVE!

//Euro" quhet monedha e vetme evropiane, e cila doli në qarkullim më 1 janar 2002. Simboli i euros është "€".



Euro ka zëvendësuar monedhat e 12 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: Austrisë, Belgjikës, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Irlandës, Italisë, Luksemburgut, Holandës, Portugalisë dhe Spanjës.

Duke patur një monedhë të vetme, është më e lehtë të udhëtosh dhe të krahasosh çmimet midis vendeve të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, monedha e njëjtë ndihmon në krijimin e një ambienti të qëndrueshëm për zhvillimin e biznesit evropian dhe për nxitjen e konkurrencës.

TË LIRË PËR TË LËVIZURI!

Në qoftë se je qytetar i Bashkimit Evropian, mund të udhëtosh, të studiosh dhe të punosh në çdo vend të Bashkimit Evropian. Gjithnjë e më shumë, Bashkimi Evropian po punon

që t'i sigurojë qytetarëve të tij më shumë liri lëvizjeje, si një nga të drejtat themeltare të tyre, dhe të mënjanojë çdo lloj diskriminimi në bazë kombësie.

Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian mund të udhëtohet pa patur pasaportë me vete, pa hasur pengesa doganore në kufi. Me pak përjashtime, mund të blihet çdo gjë dhe të transportohet në vendbanimin përkatës.



Bashkimi Evropian nuk vendos se çfarë mësohet në shkollë, por ama ai sigurohet që kualifikimet profesionale dhe arsimore të njihen në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian punon që nëpërmjet skemave të

shkëmbimit dhe të partneriteteve, t'i sigurojë mundësi për t'u shkolluar çdo qytetari brenda dhe jashtë vendit, duke shmangur kështu procedurat burokratike. Mbi një milion të rinj kanë përfituar nga programe të Bashkimit Evropian si "Erasmus", për të ndjekur studimet e tyre në një nga vendet e tij.

PAQEDASHËSI!

Lufta midis vendeve të Bashkimit Evropian është e paimagjinueshme falë unitetit që është krijuar midis tyre gjatë 50 viteve të fundit. Duke parë këtë sukses, tani Bashkimi Evropian është i angazhuar në ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit në vendet fqinje.

Bashkimi Evropian dëshiron të parandalojë konfliktet. Ai është dhuruesi më i madh i asistencës financiare në vendet e trazuara nëpër botë. Ai është aktiv në arritjen dhe në ruajtjen e paqes dhe nismëtar i shumë projekteve për të ndihmuar që ruajtja e të drejtave të njeriut dhe të demokracinë të ketë sukses edhe në praktikë.

Për t'i mundësuar vendeve anëtare të flasin dhe të veprojnë në unitet në arenën botërore, Bashkimi Evropian zhvillon politika të përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë, si dhe bën plane për rritjen e bashkëpunimit në çështjet e mbrojtjes.

VEND I LIRISË, I SIGURISË DHE I DREJTËSISË!

Të gjithë kërkojmë siguri në jetën tonë. Trazirat në vendet fqinje të Bashkimit Evropian i kanë rrënjët tek marrëdhëniet ndërkombëtare, prandaj vendet e Evropës janë angazhuar në përpjekje të përbashkëta për të zgjidhur këto probleme. Këtu përfshihen terrorizmi, trafikimi i lëndëve narkotike, trafikimi i qenieve njerëzore, shfrytëzimi në mënyrë të paligjshme për qëllime prostitucioni. Vendet e Bashkimit Evropian janë të vendosura për të luftuar këto të këqija duke implementuar rregulla të përbashkëta dhe duke nxitur bashkëpunimin midis organeve policore, të doganave dhe të gjykatave të secilit vend.

Bashkimi Evropian luan rol edhe në politikat e emigracionit dhe në ato të azilit. Ai garanton të drejtën për të kërkuar azil. Në të njëjtën kohë, vendet e Bashkimit Evropian



koordinojnë politikat e tyre për refugjatët, duke u përpjekur ta trajtojnë problemin që në rrënjë, pra tek luftimi i varfërisë dhe parandalimi i konflikteve në vendet nga duan të arratisen njerëzit.

MË PAK KUFIJ: MË TEPËR PUNË!

Mbrojtja e vendit të punës dhe krijimi i vendeve të reja është një nga detyrat kryesore të Bashkimit Evropian. Industria evropiane nuk do të mund të sigurojë vende të reja pune nëse kushtet ekonomike nuk janë të favorshme. Dhe krijimi i kushteve të favorshme është ai për të cilin punon Bashkimi Evropian.

Nëpërmjet krijimit të një tregu pa barriera kufitare dhe qarkullimit të së njëjtës monedhë, *euro*, Bashkimi Evropian tashmë i ka dhënë një shtysë të madhe tregtisë dhe punësimit në Evropë. Ai ka një strategji të përbashkët për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe për gjenerimin e një numri më të madh të vendeve të punës. Pozicionet e së nesërme do të krijohen nëpërmjet punës kërkimore, edukimit dhe trainimit, shpirtit të sipërmarrjes, adoptimit të mënyrave të reja të të punuarit dhe dhënies së mundësive të barabarta për punë.



Një e treta e buxhetit të Bashkimit Evropian shkon për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe të punënxënies në vendet më pak të zhvilluara. Kështu, mirëqenia e Evropës shpërndahet në mënyrë më të njëtrajtshme.

SHOQËRI E INFORMACIONIT PËR TË GJITHË!

Në një ambient të ndryshimeve të shpejta teknologjike, Bashkimi Evropian tregohet mjaft aktiv për të ndihmuar qytetarët në kërkimet e tyre drejt arritjeve të shkëlqyera shkencore. Në një gamë të gjerë sektorësh që mbulojnë të tërë spektrin e teknologjisë moderne, Bashkimi Evropian financon projekte të qendrave kërkimore, të universiteteve dhe të industrive të ndryshme.

Theksi qëndron tek shfrytëzimi i kërkimeve dhe i risive për realizimin e objektivave socialo-ekonomikë, si krijimi i vendeve të reja të punës apo përmirësimi i standardit të jetesës. Prioritetet në fushën e kërkimeve, midis të tjerash përfshijnë shkencat mjeksore, nano-teknologjinë, aeronautikën dhe studime të hapësirës, kërkime mbi cilësinë e ushqimit, mbi qëndrueshmërinë e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e njohurive mbi shoqërinë.

Bashkimi Evropian gjithashtu, përpiqet të krijojë kushte të cilat na lejojnë të përdorim teknologjinë e re në jetën e përditshme. Falë vendimeve të Bashkimit Evropian për standardet teknologjike 'GSM', evropianët sot kryesojnë në përdorimin dhe në prodhimin e telefonave celularë.



KUJDESI PËR AMBIENTIN!

Ndotja nuk respekton kufijtë kombëtarë. Për këtë arsye, Bashkimi Evropian luan një rol të veçantë në mbrojtjen e mjedisit. Shumë nga problemet me të, nuk mund të zgjidhen pa veprime të përbashkëta nga të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Vendet e Bashkimit Evropian kanë adoptuar mbi 200 dekrete për mbrojtjen e mjedisit. Pjesa më e madhe e direktivave janë hartuar me qëllim parandalimin e ndotjes së ajrit dhe të ujit dhe të nxisin hedhjen e mbeturinave sipas standardeve të duhura. Dekrete të tjera lidhen me konservimin e vlerave natyrore dhe me mbikëqyrjen e proceseve të rrezikshme industriale. Bashkimi Evropian synon që transporti, industria, bujqësia, peshkimi, energjia dhe turizmi të jenë të organizuara në mënyrë të tillë, që të zhvillohen pa shkatërruar burimet natyrore – me pak fjalë, ai synon të arrijë zhvillim të qëndrueshëm.

Ajri që thithim është më i pastër, që kur në vitin 1990 Bashkimi Evropian detyroi të gjitha makinat të vendosnin marmita katalitike dhe të mos i shtojnë plumb lëndës djegëse.

Në vitin 1993, Bashkimi Evropian ngriti Agjencinë Evropiane të Mjedisit me qendër në Kopenhagë. Kjo agjenci mbledh informacion mbi gjendjen e mjedisit dhe harton ligje e masa mbrojtëse bazuar në të dhëna nga të gjitha vendet anëtare.



PARLAMENTI EVROPIAN ZËRI I POPULLIT!

Parlamenti Evropian është zëri demokratik i popullit evropian. Të zgjedhur një herë në pesë vjet, anëtarët e Parlamentit Evropian nuk grupohen sipas përkatësisë kombëtare, por sipas shtatë grupeve politike. Çdo grup, përfaqëson një ideologji të partisë politike në të cilën bën pjesë. Jo të gjithë parlamentarët janë anëtarë të ndonjë partie politike. Në zgjedhjet parlamentare të qershorit të vitit 1999, rreth 30 për qind e deputetëve ishin femra.

Rolet kryesore të Parlamentit janë:

- Të ekzaminojë dhe të zbatojë legjislacionin evropian. Sipas procedurave për vendimmarrjen e përbashkët, Parlamenti e ndan këtë fuqi në mënyrë të barabartë me Këshillin e Ministrave.
- Të miratojë buxhetin e Bashkimit Evropian.
- Të ushtrojë kontroll demokratik mbi institucionet e tjera të Bashkimit Evropian mundësisht duke ngritur komitete kontrolli.



- Të miratojë marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare, si hyrja e anëtarëve të rinj në Bashkimin Evropian dhe marrëveshjet e tregtisë dhe asociimit midis Bashkimit Evropian dhe vendeve të tjera.

Parlamenti Evropian ka krijuar edhe Çmimin Sakharov, i cili i akordohet çdo vit individëve apo grupeve, që kanë punuar me sukses për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në botë.

Sikurse parlamentet kombëtare, Parlamenti Evropian ka komitetet e veta, që merren me çështje të veçanta (politikën e jashtme, buxhetin, mjedisin etj.). Nëpërmjet njërit prej tyre, Komitetit të Peticionit, qytetarët evropianë mund t'i adresojnë peticionet e tyre direkt në Parlamentin Evropian. Parlamenti emëron Avokatin e Popullit, i cili shqyrton ankesat nga qytetarët për raste të keqadministrimit në Bashkimin Evropian.

Që prej vitit 2002, President i Parlamentit Evropian është z. Pat Cox. Vendndodhja e Parlamentit Evropian është në Francë, Belgjikë dhe Luksemburg.

Sesionet parlamentare me të gjithë deputetët mbahen në Strazburg (Francë).

Komitetet Parlamentare mbledhen në Bruksel (Belgjikë), ndërsa zyrat e administratës së Parlamentit Evropian ndodhen në Luksemburg.



Pat Cox, President i Parlamentit Evropian.

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN ZËRI I VENDEVE ANËTARE!

Këshilli Evropian – më përpara i njohur si Këshilli i Ministrave – është organi kryesor legjislativ dhe vendimmarrës në Bashkimin Evropian. Ai përbëhet nga përfaqësues të qeverive të vendeve anëtare që zgjidhen në nivel kombëtar. Ai funksionon si një forum, në të cilin përfaqësuesit e qeverive mund të shprehin interesat e tyre dhe të arrijnë në kompromise. Ata takohen rregullisht në grupe pune, në nivel ambasadorësh, ministrash apo – kur vendosin për politika të rëndësishme – në nivel presidentësh dhe kryetarë qeverish.

Këshilli, së bashku me Parlamentin Evropian, vendos rregullat për të gjitha aktivitetet e Komunitetit Evropian, i cili formon “shtyllën” e parë të Bashkimit Evropian. Këshilli vendos, mbikëqyr dhe koordinon aktivitetet, për pjesën më të madhe të politikave të përbashkëta të Bashkimit Evropian si dhe garanton lirinë e lëvizjes së mallrave, të individëve, të shërbimeve dhe të kapitalit në Komunitet.

Përveç kësaj, Këshilli është organi kryesor përgjegjës për “shtyllën” e dytë dhe të tretë – bashkëpunimin ndërqeveritar për politikën e përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë dhe bashkëpunimin në fushën e drejtësisë dhe politikën e brendshme. Kjo nënkupton që, për shembull, qeveritë e Bashkimit Evropian po bashkëpunojnë për të luftuar terrorizmin dhe trafikimin e lëndëve narkotike. Ato kanë bashkuar forcat për të folur me një zë për politikën e jashtme, të ndihmuar edhe nga Përfaqësuesi i Lartë për politikën e përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë.

Presidenca e Këshillit Evropian ndërron çdo gjashtë muaj. Me fjalë të tjera, secili nga vendet e Bashkimit Evropian, sipas radhës,

drejton mbledhjet e Këshillit për gjashtë muaj, duke u përpjekur të nxisë arritjen e marrëveshjeve ndërmjet vendeve anëtare në marrjen e vendimeve politike dhe ligjvënëse. Për shembull, nëse Këshilli mbi Çështjet e Mjedisit do të mbledhet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006, mbledhja do të drejtohet nga Ministri i Çështjeve të Mjedisit të Finlandës, pasi në atë periudhë Finlanda është kryetare e Presidencës së Këshillit Evropian.

Radha për kryesimin e Presidencës së Këshillit Evropian është si më poshtë:

2003	Gjysma e parë e vitit:	Greqia
	Gjysma e dytë e vitit:	Italia
2004	Gjysma e parë e vitit:	Irlanda
	Gjysma e dytë e vitit:	Holanda
2005	Gjysma e parë e vitit:	Luksemburgu
	Gjysma e dytë e vitit:	Mbretëria e Bashkuar
2006	Gjysma e parë e vitit:	Austria
	Gjysma e dytë e vitit:	Finlanda

Në ndihmë të Presidencës funksionon Sekretariati i Përgjithshëm, i cili përgatit dhe siguron realizimin e detyrave të Këshillit Evropian. Në vitin 1999, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Evropian u emërua z. Javier Solana. Ai është gjithashtu, Përfaqësuesi i Lartë për politikën e përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë. Në emër të Këshillit Evropian, z. Solana merr pjesë në dialogjet politike me vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Vendimet e Këshillit Evropian merren në bazë votash. Sa më e madhe popullsia e një vendi aq më shumë vota i akordohen atij. Megjithatë, ky numër nuk mbështetet vetëm në përpjesëtime, por favorizon edhe vendet jo shumë të populluara.

Deri më 1 maj 2004, numri i votave për çdo vend ishte si më poshtë:

Gjermania, Franca, Italia, Mbretëria e Bashkuar	10
Spanja	8
Belgjika, Greqia, Holanda, Portugalia	5
Austria, Suedia	4
Danimarka, Irlanda, Finlanda	3
Luksemburgu	2
TOTALI	87

Nga data 1 maj 2004 (kur 10 vende të reja hynë në Bashkimin Evropian) deri më 31 tetor 2004, numri i votave do të caktohet me marrëveshje. Nga data 1 nëntor 2004, numri i votave që ka secili vend anëtar do të jetë si më poshtë:

Gjermania, Franca, Italia, Mbretëria e Bashkuar	29
Spanja dhe Polonia	27
Holanda	13
Belgjika, Republika Çeke, Hungaria, Greqia dhe Portugalia	12
Austria, Suedia	10
Danimarka, Irlanda, Lituania, Sllovakia dhe Finlanda	7
Qipro, Estonia, Letonia, Luksemburgu dhe Sllovenia	4
Malta	3
TOTALI	321

Sipas skemës së re, që një vendim të miratohet duhet që të ketë votuar pro shumica e vendeve anëtare ose të paktën 72.3 për qind e votave (në disa raste kërkohet 75 për qind e votave). Secili vend anëtar mund të kërkojë konfirmim nëse ky numër votash përfaqëson të paktën 62 për qind të popullsisë së Bashkimit Evropian. Në rast të kundërt, vendimi nuk miratohet.



<http://ue.eu.int>

Javier Solana, fytyra e diplomacisë së Bashkimit Evropian. Përfaqësuesi i Lartë për politikat e përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë.

KOMISIONI EVROPIAN FORCA SHTYTËSE E UNIONIT!

Komisioni Evropian është organi ekzekutiv i Bashkimit Evropian dhe merret pothuajse për ditë me funksionimin e duhur të tij.

Ai harton propozime për ligje të reja evropiane, të cilat i paraqet përpara Parlamentit dhe Këshillit Evropian. Komisioni sigurohet se vendimet e Bashkimit Evropian zbatohen siç duhet dhe mbikëqyr mënyrën sesi shpenzohen fondet e Bashkimit Evropian.

Ai gjithashtu, mban një sy hapur për të parë se secili vepron në përputhje me ligjet dhe me traktatet evropiane.

Komisioni Evropian përbëhet nga 30 anëtarë (gra dhe burra) dhe kanë në mbështetjen e tyre një grup administrativ prej 24000 vetash. Presidenti i Komisionit zgjidhet nga qeveritë e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe duhet të miratohet nga Parlamenti Evropian. Anëtarët e tjerë kandidohen nga qeveritë e vendeve anëtare, në konsultim me presidentin e ardhshëm dhe duhet të miratohen nga Parlamenti. Komisioni ka një mandat pesëvjeçar por ai mund të shpërndahet më përpara nga Parlamenti.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë si përfaqësues të tyre nga një komisioner, me përjashtim të vendeve më të populluara që kanë nga dy komisionerë.

Me hyrjen e vendeve të tjera në Bashkimin Evropian, si Bullgaria dhe Rumania, numri i vendeve anëtare do të arrijë në 27, gjë që do të çojë edhe në rritjen e numrit të komisionerëve. Kjo gjë

do ta bënte të vështirë arritjen e marrëveshjeve ndërmjet vendeve anëtare. Prandaj, me zgjedhjet e reja, Komisioni i ri Evropian (2004-2009) do të përcaktojë dhe një numër të pandryshueshëm komisionerësh, numër i cili do të jetë më i vogël sesa 27.

Komisioni vepron në mënyrë të pavarur nga qeveritë e vendeve anëtare. Shumë, por jo i tërë stafi i tij punojnë në Bruksel, Belgjikë. Komisioni Evropian ka përfaqësues të tij edhe në vende të tjera, të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Kështu, ai shërben si delegacion në emër të Bashkimit Evropian për negociimin e marrëveshjeve me këto vende.

<http://europa.eu.int/comm>



GJYKATA E DREJTËSISË ZBATIMI I LIGJIT!

Kur vendosen rregulla të përbashkët në Bashkimin Evropian, është sigurisht e domosdoshme që ata të ndiqen në praktikë – dhe që ata të kuptohen njësoj kudo. Këtë siguron edhe Gjykata e Drejtësisë në Komunitetin Evropian. Ajo zgjidh debatet mbi mënyrën sesi interpretohen marrëveshjet dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian. Në rast se gjykatat në nivel kombëtar nuk janë të sigurta sesi duhet t’i zbatojnë rregullat e Bashkimit Evropian, atëherë ato duhet të pyesin Gjykatën e Drejtësisë. Edhe individët mund të nisin procedurat e padive ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian pranë kësaj Gjykate. Ajo përbëhet nga gjykatës të pavarur – nga një përfaqësues për çdo vend anëtar - dhe ndodhet në Luksemburg.

<http://curia.eu.int>

GRUPI EVROPIAN I AUDITORËVE VLERË PËR PARATË E QYTETARËVE!

Fondet në dispozicion të Bashkimit Evropian duhet të përdoren ekonomikisht, sipas ligjit, dhe sipas qëllimit të përcaktuar më parë. Grupi i Auditorëve, një institucion i pavarur i Bashkimit Evropian me vendndodhje në Luksemburg, është organi që kontrollon nëse paratë e Bashkimit Evropian janë shpenzuar sipas kritereve të përcaktuara. Në fakt, këta auditorë, i sigurojnë taksapaguesit evropianë se paratë e tyre, të cilat kanalizohen në vendet e Bashkimit Evropian nuk keqpërdoren apo abuzohen.

www.eca.eu.int

*BANKA QENDRORE EVROPIANE¹
MONEDHË E QËNDRUESHME PËR EVROPËN!*

Banka Qendrore Evropiane është përgjegjëse për monedhën e vetme, euron. E pavarur, Banka administron politikën monetare të Bashkimit Evropian – për shembull, vendos sesa të larta duhet të jenë normat e interesave. Objektivi kryesor i Bankës është të sigurojë stabilitetin e çmimeve, në mënyrë që ekonomia të mos dëmtohet nga inflacioni. Por politika monetare mbështet edhe në objektiva të tjerë politikë të Bashkimit Evropian. Banka Qendrore Evropiane ndodhet në Frankfurt, Gjermani. Ajo drejtohet nga një president dhe një bord ekzekutiv në bashkëpunim të ngushtë me bankat qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

www.ecb.int

*BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE
INVESTIM PËR TË ARDHMEN!*

Banka jep kredi për investime me interes për Evropën, në veçanti për investime me përfitim për rajonet më pak të zhvilluara.

Për shembull, ajo financon ndërtimin e lidhjeve hekurudhore, të autostradave, të aeroporteve, skema për ruajtjen e ambientit, dhe nëpërmjet bankave partnere, financon investimet e ndërmarrjeve të mëdha dhe të vogla që ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës. Kreditë ndihmojnë Bashkimin

¹ Për informacion më të hollësishëm mbi organizimin dhe funksionimin e Bankës Qendrore Evropiane, ju lutem referojuni publikimit “Banka Qendrore Evropiane”, botim i Bankës së Shqipërisë, shtator 2003.

Evropian edhe në procesin e zgjerimit të tij dhe në politikat e ndihmëse për zhvillimin e vendeve të tjera. Banka e ka qendrën në Luksemburg dhe siguron fonde nëpërmjet tregjeve të kapitalit.

Duke qenë organizatë jofitimprurëse ajo jep kredi me terma të favorshëm.

www.eib.org

KOMITETI I ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE EKONOMIKE PARTNERË TË SHOQËRISË CIVILE!

Duke nisur nga punëdhënësit tek sindikatat dhe nga konsumatorët tek ekologjistët, të 314 anëtarët e Komitetit të Çështjeve Sociale dhe Ekonomike përfaqësojnë të gjitha grupet e interesit, më të rëndësishmet në Bashkimin Evropian.

Ai është një autoritet këshillues dhe duhet të japë opinionin e vet në aspekte të rëndësishme të iniciativave të reja të Bashkimit Evropian. Përfshirja e shoqërisë civile në jetën politike është pjesë e traditës së përbashkët evropiane.

www.esc.eu.int

KOMITETI RAJONAL NJË KËNDVËSHTRIM LOKAL!

Shumë vendime që merren në Bashkimin Evropian kanë ndikime direkte në plan rajonal dhe lokal. Nëpërmjet Komitetit të Rajoneve, Bashkimi Evropian përpara se të marrë vendime në fushën e arsimit, të shëndetit, të punësimit dhe të

transportit, konsultohet me autoritetet lokale dhe rajonale. Në shumicën e rasteve, anëtarët e Komitetit janë kryetarë bashkish apo prefekturash.

www.cor.eu.int

SHTRIRJE PËR NJË EVROPË MË TË FORTË DHE TË QËNDRUESHME!

Në 1 maj 2004, të 15 vendeve të Bashkimit Evropian iu bashkëngjiten edhe 10 vende të reja, duke e çuar popullsinë e Bashkimit Evropian në mbi 455 milionë banorë (një rritje prej 77 milionë banorësh) ndërsa sipërfaqen e tij në 3.9 milionë km². Vendet e reja i përkasin një rajoni të gjerë, prej Baltikut në Mesdhe, dhe kjo ka rritur edhe numrin e gjuhëve që fliten në Bashkimin Evropian, nga 11 në 20.

HISTORIKU I SHTRIRJES SË BASHKIMIT EVROPIAN.

1952	Vendet themeluese të BE: Belgjikë, Francë, Gjermani, Itali, Luksemburg, Holandë
1973	Zgjerimi i parë: Danimarkë, Irlandë, Mbretëri e Bashkuar
1981	Zgjerimi i dytë: Greqi
1986	Zgjerimi i tretë: Spanjë, Portugali
1985	Zgjerimi i katërt: Austri, Finlandë, Suedi
2004	Zgjerimi i pestë: Qipro, Republika Çeke, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni

Ky është zgjerimi i pestë dhe më i madh e ambicioz i Bashkimit Evropian që me krijimin e tij. Asnjëherë më parë Bashkimi Evropian nuk ka përqafuar kaq shumë vende të reja, nuk është

rritur kaq shumë në numrin e popullsisë dhe të sipërfaqes dhe nuk ka përfshirë kaq shumë larmi në historikun dhe në kulturën e vet. Kjo ngjarje ka bashkuar më tej kontinentin evropian, ka konsoliduar paqen, stabilitetin dhe demokracinë, dhe i ka mundësuar vendeve të reja të ndajnë përfitimet nga progresi dhe mirëqenia që sjell integrimi në Bashkimin Evropian.

Bullgaria dhe Rumania pritet të hyjnë në Bashkimin Evropian në vitin 2007. Pas kësaj, popullsia e Bashkimit Evropian do të arrijë në 500 milionë banorë. Turqia është gjithashtu, vend kandidat për të hyrë në Bashkimin Evropian, por ende nuk ka plotësuar të gjitha kushtet për këtë.

Për të qenë anëtar i Bashkimit Evropian, një vend duhet të ketë demokraci të qëndrueshme dhe të garantojë zbatimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, si dhe të ketë një ekonomi tregu funksionuese sikurse dhe kapacitetet njerëzor për të zbatuar dhe për të administruar ligjet e Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian u siguron ndihmë financiare dhe këshilluese të konsiderueshme vendeve candidate, duke i përgatitur ato për anëtarësim. Ky lloj bashkëpunimi pa shembull u ka sjellë përfitime vendeve të tanishme dhe të ardhshme, anëtare. Tregtia është rritur masivisht dhe është më e lehtë të trajtosh probleme të cilat na ndikojnë të gjithëve, si ndotja dhe lufta kundër kimit.

RUAJTJA E DEMOKRACISË EVROPIANE E ARSYESHME DHE EFICIENTE!

Bashkimi Evropian ka nevojë për një sistem vendimmarrës të drejtë dhe eficient, ndërsa zgjerohet nga 15 në 25 vende. Ky sistem duhet të jetë i njëjtë dhe i drejtë për të gjitha vendet anëtare, qofshin të reja apo të vjetra, të vogla apo të mëdha.

Çdo vend anëtar ka në dispozicion një numër të caktuar votash, të cilat i përdor kur merren vendime të Këshillit të Ministrave. Nga ana tjetër, çdo vend zgjedh një numër përfaqësuesish si anëtarë të Parlamentit Evropian. Këta numra, pjesërisht reflektojnë madhësinë relative të popullsisë së vendit.

	Numri i votave në Këshillin Evropian	Numri i anëtarëve në Parlamentin Evropian
Belgjika	12	24
Qipro	4	6
Republika Çeke	12	24
Danimarka	7	14
Gjermania	29	99
Greqia	12	24
Spanja	27	54
Estonia	4	6
Franca	29	78
Hungaria	12	24
Irlanda	7	13
Italia	29	78
Letonia	4	9
Lituania	7	13
Luksemburgu	4	6
Malta	3	5
Holanda	13	27
Austria	10	18
Polonia	27	54
Portugalia	12	24
Slovakia	7	14
Slovenia	4	7
Finlanda	7	14
Suedia	10	19
Mbretëria e Bashkuar	29	78
TO TALL	321	732

Bashkimi Evropian ka nevojë edhe për një traktat të thjeshtë – kushtetutën, e cila përcakton qartë qëllimet dhe vlerat e Bashkimit Evropian dhe përshkruan se kush është përgjegjës për çfarë.

Për të hartuar këtë dokument, në vitin 2002 u ngrit një Konventë, e cila përbëhej nga përfaqësues të vendeve anëtare dhe të atyre kandidatë, sikurse dhe nga përfaqësues të institucioneve të Bashkimit Evropian. Në qershor të vitit 2003 përfundoi hartimi i draftit të kushtetutës së Bashkimit Evropian.

Miratimi dhe nënshkrimi i tij nga vendet anëtare (përfshirë 10 anëtarët e rinj) do të bëhet brenda vitti 2004.

Më shumë informacion mbi Konventën mund të gjeni tek:

<http://european-convention.eu.int>


SI MUND TË KONTAKTOJMË ME BASHKIMIN EVROPIAN?

Zyra të përfaqësimit të Komisionit dhe Parlamentit Evropian gjenden në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian ka delegacionet e veta edhe në vende të tjera të botës.

Në Shqipëri, delegacioni i Komisionit Evropian kryesohet nga z. Lutz Saltzman dhe zyrat e këtij delegacioni ndodhen në qendër të Tiranës (Rr. "Donika Kastrioti", Vila 42).

Informacion në të gjitha gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian gjendet në internet, në adresën <http://europa.eu.int> Në të gjithë Evropën gjenden qindra qendra për informim mbi Bashkimin Evropian. Adresat e qendrave më pranë jush mund t'i gjeni në http://europa.eu.int/comm/relays/index_en.htm EUROPE DIRECT është një shërbim, i cili i përgjigjet pyetjeve tuaja mbi Bashkimin Evropian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni me e-mail duke shkuar tek <http://europa.eu.int/europedirect>.





Përshtatur në shqip nga botimi i Komisionit Evropian
“Panoramë e Bashkimit Evropian”, prill 2003. Titulli në
origjinal “Panorama of the European Union”.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr.1,
Tiranë.

Tel: (355) 4 222230; 235568; 235569.

Faks: (355) 4 223558.

e-mail: public@bankofalbania.org

<http://www.bankofalbania.org>

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi: 1000 kopje.